

URDHËR
Nr.499, datë 7.10.2011

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË TË DOKTORATËS, NË QENDRËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen, në Qendrën e Studimeve Albanologjike (QSA) të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të Doktoratës, në “Historia e arteve shqiptare”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr) në “Historia e arteve shqiptare”.

2. Programi i studimeve të ciklit të tretë, të Doktoratës, zgjat të paktën 3 vite akademike dhe përfshin 60 kredite për studime të organizuara teorike.

3. Programi i studimeve të fillojë në vitin akademik 2011-2012.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i Qendrës së Studimeve Albanologjike, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Qendra e Studimeve Albanologjike, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj